

Zanafilla e historisë së kamp – burgut të Spaçit

- 25 Maj 1951 - Me urdhër të posaçëm të Ministrit të Punëve të Brendshme u krijua Kampi nr. 2. Hapja e këtij kampi shënoi zanafillën e historisë së kamp-burgut të Spaçit. Në vitet 1951-1968 shërbeu si një repart pune “lëvizës” dhe ata që punonin aty ishin të gjithë të dënuar politikë.
- Vitet 1951 - 1952 - Në këtë interval kohor kampi ndoqi një itinerar të bazuar në nevojat e kohës. Së pari, në hapjen e kanaleve vaditëse Peqin-Kavajë dhe ndërtimin e digës së lumit Shkumbin. Për punën e kryer u shpërbyen me pagesë 60% e efektivit që ruante kampin. Disa oficerë dhe nënoficerë u dekoruan me medalje pune.
- Viti 1953 - Deri në marsin e këtij viti, ndihmoi Kampin nr.1 në Urën Vajgurore për ndërtimin e fushës së aviacionit. Më pas u transferua në Vlashuk pranë Kuçovës, për shkak të nevojës së punimeve për ndërtimin e kanalit vaditës Devoll-Thanë, me një gjatësi prej 8 km.
- Maj 1955 – Kampi nr.2 u aktivizua në ndërtimin e kanalit vaditës Vjosë - Levan-Fier, për këtë arsye kampi u transferua në Shtyllas të Fierit.
- Qershor 1955 – 1959 - Kampi nr. 2 punoi katër vjet për ndërtimin e fushës së Aviacionit në Rinas.
- 8 shkurt 1959 – Të burgosurit politikë punuan për ndërtimin e Sanatoriumit, të Kombinatit të Mishit, të Peliçerisë, në ndërtimin e disa ndërtesave në fermën “Gjergj Dimitrov” dhe gjithashtu në një pjesë të punimeve në Uzinën e Traktorëve.
- Viti 1963 – Kampi Nr.2 u zhvendos në Vlorë, ku punon për ndërtimin e uzinës së Sodës Kaustike të qytetit.
- Viti 1965 - Dy vite më pas të burgosurit u dërguan në Elbasan për ndërtimin e fabrikës së Çimentos.
- Viti 1968 - Kampi u vendos përfundimisht pranë minierës së piritit në Spaç, aty ku do të njihet historikisht si “Reparti i Riedukimit nr. 303 në Spaç”, (Reparti 303). Në të vërtetë ai nuk ishte një kamp riedukimi, por kamp dhe burg njëherësh.
- Janar 1969 – Dega e Punëve të Brendshme në Mirditë, organi i Ministrisë së Punëve të Brendshme që mbikëqyrte Repartin 303, Spaç, për shkak të rëndësisë politike ekonomike dhe strategjike u vendo që të hapej dosja e “objektit të rëndësisë së veçantë për Repartin e Riedukimit nr. 303, Spaç - Mirditë” (ORV).
- 21 - 23 Maj 1973 – U zhvillua Revolta e Spaçit e konsideruar ndryshe si e para revoltë dhe më e rëndësishmja në burgjet e Shqipërisë komuniste. Pas shtypjes me dhunë të revoltës, 4 të dënuar politikë u ekzekutuan me pushkatim ndërsa rreth 60 të tjerë u ridënuan.

- Viti 1984 - Përveç të burgosurve politikë, nga dokumentet e dosjes ORV, rezulton se në kampin-burg të Spaçit vuanin dënimin edhe të burgosur ordinerë.
- Qershor 1990 – Nga Spaçi, të dënuarit politikë u zhvendosën fillimisht në Qafë Bari, në Burgun 313 të Tiranës dhe më pas në Repartin 305 në Sarandë. Aty vazhduan të qëndronin vetëm të burgosurit ordinerë, deri në fund të muajit korrik, të vitit 1991.
- Korrik 1991 - Kampi - burg i Spaçit u mbyll përfundimisht.
- Nëntor 1991 - Dosja e kampit-burg të njohur me emrin “Reparti i Riedukimit nr. 303 Spaç” u arkivua përfundimisht disa muaj pas rrëzimit të regjimit komunist në Shqipëri.